



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 03.06.2026

MBLEDHJA Nr. 25,
Datë 05.06.2026, ora 11:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 05.06.2026, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 25 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të bordit nr.21 dt.06.05.2026, nr.22 dt.13.05.2026, nr.23 dt.21.05.2026 dhe nr.24 dt 25.05.2026.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREENSOL” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “NEXORA” shpk për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” shpk për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike tek shoqëria “Hec Polemi” shpk.
6. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ere-s nr. 68, datë 08.04.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “RENEW” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”, i ndryshuar.
7. Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 199, datë 15.08.2025 “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Procredit Bank” sha”.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” shpk për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Intesa SanPaolo Bank Albania” sha.

9. Mbi miratimin e disa ndryshimeve në treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

10. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI